

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 6547 prot, datë 31.07.2023, ju informojmë si më poshtë:

Nga data 1 maj 2022, në zbatim të VKM nr.252, datë 29.04.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", të gjitha aplikimet për shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizohen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania.

Nga verifikimet e kryera në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë rezulton se, në datën 16.11.2022, z. Zeqir Fejzulla ka aplikuar online në portalin e-Albania me kërkesën "Për caktim pensioni pleqërie". Kjo kërkesë është refuzuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, pasi për të përfituar pension pleqërie z. Fejzulla duhet të shkëpusi marrëdhëniet financiare me subjektin Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor Tiranë.

Në nenin 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në RSH" (të ndryshuar), përcaktohet se:

- 2. Përfituesi nuk ka të drejtë për këste përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar;*
- 3. Pagesat e të ardhurave ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë ekonomikisht aktiv.*

Pas datës 16.11.2022 deri sot, në portalin e-Albania nuk figuron asnjë kërkesë tjetër për pension pleqërie në emër të z. Zeqir Fejzulla.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.